



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E  
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
**DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 475 Prot., datë 29.12 . 2020

Nr. 1695 Prot., datë 29.12 . 2020

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Lidhur ndërmjet

### PALËVE:

**AUTORITETIT TË KONKURENCËS** (në vijim "AK") përfaqësuar nga Kryetarja e Komisionit znj. **Juliana LATIFI**

dhe

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE** (në vijim "KDMDP") përfaqësuar nga Komisioneri z. **Besnik DERVISHI**

Të ndërgjegjshëm për rolin dhe detyrat e rëndësishme që ligjet organike kanë parashikuar për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Në respekt të misionit dhe vlerave institucionale të përbashkëta të secilit nga këto institucione, për të nxitur transparencën dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë në treg, mbrojtjen e të dhënave personale, si një model për shoqërinë në garantimin dhe zbatimin e të drejtave themelore të njeriut;

Me dëshirën e mirë për të konsoliduar dhe rritur bashkëpunimin tonë në drejtime konkrete, palët bien dakord për sa vijon:

## **Neni 1**

### **Objekti**

Objekti i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (në vijim “*Memorandumi*”), është institucionalizimi i marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve dhe rritjen e ndërveprimit në fusha ku ndërthuren kompetencat e tyre, në kuadër të garantimit të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Bashkëpunimi i palëve do të realizohet mbi baza të njëjta dhe mbi parimin e reciprocitetit.

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Baza ligjore e këtij Memorandumi është ligji nr.9121 datë 28.07.2003 “*Për mbrojtjen e konkurrencës*”, ligji nr.119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, ligji nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi në momentin e nënshkrimit të këtij Memorandumi.

## **Neni 3**

### **Sfera e bashkëpunimit**

AK dhe KDIMDP angazhohen të bashkëpunojnë në :

- a. dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve respektivisht në hartimin e akteve të ndryshme, që prekin objektin e veprimit të palës tjetër;
- b. shkëmbimin e vazhdueshëm të ekspertizës dhe praktikave të reja;
- c. realizimin e ndërlidhjes midis konkurrencës, konsumatorit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në kuadër të legjislacioneve respektive si dhe identifikimin e sfidave në ndërtimin e transparencës, besimit dhe llogaridhënies;
- d. ngritjen e grupeve të punës për hartimin e udhëzuesve në veprimtarinë e sektorëve të veçantë, në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale në tregut e ekonomisë dixhitale dhe konkurrencës;
- e. garantimin nga ana e palëve të standardeve më të mira gjatë procesit të transferimit ndërkombëtarë të të dhënave me autoritetet ndërkombëtare apo simotra;
- f. nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare me interes reciprok që i shërbejnë zbatimit të ligjeve respektive;



#### **Neni 4**

### **Të drejta dhe detyrimet e palëve**

Në përmbushje të këtij Memorandumi, AK dhe KDIMDP kanë këto të drejta dhe detyrime:

- a. të marrin pjesë në takime të grupeve të punës të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i këtij Memorandumi;
- b. të kërkojnë informacione për veprimtarinë e palës tjetër në funksion të veprimtarisë përkatëse;
- c. të kërkojnë mendimet dhe sugjerimet e njëra-tjetrës, në rastet e nxjerrjes së akteve të propozuara, që prekin objektin e veprimtarisë së palës tjetër;
- d. të bëjnë të disponueshëm kundrejt kërkesave të arsyetuara dokumente/informacione të punës, të konsideruar si jo konfidenciale;
- e. të bashkërendojnë punën për hartimin e programeve të transparencës;
- f. të ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të dhëna nga pala tjetër;
- g. të asistojnë njëra - tjetrën në hartimin dhe miratimin e rregulloreve, veçanërisht sa i përket sigurisë së të dhënave personale dhe sigurisë së informacionit bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### **Neni 5**

### **Koordinimi ndërmjet palëve**

1. Në zbatim të këtij Memorandumi AK dhe KDIMDP caktojnë në cilësinë e personave të kontaktit përkatësisht:

Për KDIMPDP:

Për AK:

2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format me të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

#### **Neni 6**

### **Koherenca e takimeve mes palëve**

Titullarët e lartë të palëve respektive do të takohen rregullisht dhe jo më pak se dy herë në vit për t'u konsultuar për sa i përket implementimit të këtij Memorandumi, në mënyrë që të vendosin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize për vazhdimin e të njëjtit akt, shkëmbimin e pikëpamjeve dhe sipas mundësisë, do të ndërmarrin veprime dhe pozicione të

përbashkëta në forume dhe organizata evropiane dhe ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me sektorin e mbrojtjes së konkurrencës dhe të dhënave personale.

#### Neni 7

#### Analiza e zbatimit të Memorandumit

Palët do të shqyrtojnë në baza dyvjetore, rezultatet e bashkëpunimit të tyre sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Sipas nevojës, palët do të ndërmarrin hapa për përmirësimin e bashkëpunimit dhe do të bëjnë propozime të përshtatshme për të ndryshuar fushën e veprimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

#### Neni 8

#### Afati i Memorandumit

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Memorandumi mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën një muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga ky Memorandum, për sa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të tij.

#### Neni 9

#### Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.
2. Memorandumi është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Autoritetin e Konkurrencës dhe dy të tjera në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

U firmos dhe hyn në fuqi me datë 29/12/2020

PËR  
AUTORITETIN E KONKURRENCËS



PËR  
KOMISIONERIN  
PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE

